



**INSTITUTI
I SIGURIMEVE
SHOQËRORE**

RAPORT VJETOR

2017



**INSTITUTI
I SIGURIMEVE
SHOQËRORE**

2017

RAPORT VJETOR

“Mbi aktivitetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”

Adresa:

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë

kontakt@issh.gov.al

www.issh.gov.al

- Profili i Institutit të Sigurimeve Shoqërore
- Këshilli Administrativ i ISSH-së
- Grupi i Menaxhimit Strategjik, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore
- Struktura organizative e Institutit të Sigurimeve Shoqërore
- Legjislacioni
- Ecuria e reformës në pensione
- Kontributet
- Përfitimet që ofron ISSH
- Marrëdhëniet ndërkombëtare
- Zhvillimi i burimeve të informacionit
- Informimi publik
- Administrimi i përgjithshëm
- Raporti financiar 2017
- Statistika të sigurimeve shoqërore

I dashur lexues!

Raporti vjetor 2017 përmban një analizë të veprimtarisë së institucionit tonë, për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave ligjore të tij. Ai përshkruan gjerësisht aktivitetet e ISSH-së, në hallkat kryesore të funksionimit të tij.

Gjatë vitit 2017, Instituti i Sigurimeve Shoqërore i ka shërbyer në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet caktimit të pensioneve të reja, mbylljeve, rillogaritjeve, komisionimeve, kompensimeve, kërkesave, ankesave etj rreth 400 mijë personave.

Janë zbatuar standarte të reja për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj pensionistëve. Hapi më i rëndësishëm është bërë në drejtim të transparencës së pagesave nëpërmjet qeverisjes së tyre me sisteme informatike, të cilat, ndër të tjera, kanë përmirësuar ndjeshëm edhe administrimin financiar të sistemit. Evidentojmë këtu punën e bërë në luftën kundër informalitetit, si në fushën e të ardhurave, ashtu edhe në fushën e përfitimeve. Kjo është arritur nëpërmjet krijimit të bazës së të dhënave të përfituesve e kontribuesve, lidhjes së tyre me Regjistrin e Gjendjes Civile dhe databazat e sistemeve të tjera.

Përfundoi databaza e përfitimeve dhe sistemi i informatizuar i pagesave të pensioneve. Gjatë vitit 2017 u futën në sistem 100% e pagesave të përfitimeve në të gjithë qytetet dhe në 9 prefektura të RSH edhe për pagesat në zyrat postare të fshatrave.

U tejkaluan ndjeshëm të ardhurat në të gjithë zërat e programuar apo subjektet kontribues.

Rëndësi e veçantë iu kushtua zbatimit të standarteve të pagesave nga agjentët pagues dhe kontrollit të ligjshmërisë së tyre, caktimit të përfitimeve, ndjekjes së evadimit nga sistemi të pensioneve të mbyllura dhe të arkëtimeve që lidhen me to.

Viti 2017, mbyll me një rezultat shumë pozitiv, pra tejkalim të të hyrave me shpenzimet me 3,180 milionë lekë, i cili drejtpërdrejt reflekton të gjithë mundësitë për plotësimin e normativës së Fondit Rezervë të sigurimeve shoqërore, si dhe për një reduktim të mëtejshëm të deficitit vjetor të sistemit.

Gjatë vitit 2017 është ndjekur zbatimi i marrëveshjeve të lidhura me Turqinë, Hungarinë, Maqedoninë, Çekinë, Luksemburgun, Gjermaninë, Austrinë dhe u hap rruga e ratifikimit për Kosovën e Rumaninë.

Të gjitha këto arritje nga stafi i ISSH përbëjnë një bazë të mirë për realizimin e detyrave të vitit pasardhës, të cilat janë ndjeshëm më të larta se sa ato të vitit pararendës, si dhe shërbejnë si shtysë për përballimin me sukses të të gjitha sfidave institucionale me të cilat do të ndeshemi gjatë vitin 2018.

Pjesë përbërëse e Raportit Vjetor janë edhe pasqyrat statistikore për vitin 2017.

PROFILI I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është një institucion publik, i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me dispozitat e Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ka si qëllim mbrojtjen sociale, menaxhimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe dhënien e përfitimeve.

Këshilli i Ministrave miraton statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili normon veprimtarinë e këtij institucioni dhe marrëdhëniet ndërmjet tij dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore mbështetet në parimin kontributiv, parimin e vetëpërgjegjësisë së individit për risqet e së ardhmes në fushën sociale, si dhe në parimin e marrëveshjes së brezave “pagaaj sot që të përfitosh nesër (pay as you go)”.


Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullon dhe përcakton mënyrën e drejtimit dhe të administrimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Sipas këtij Ligji, Instituti i Sigurimeve Shoqërore drejtohet nga:

1. Këshilli Administrativ;
2. Drejtori i Përgjithshëm.

Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore është organi më i lartë ekzekutiv.

Ai përbëhet nga 12 anëtarë dhe mbështetur në VKM nr. 263, datë 07.05.2014 “Për caktimin e funksioneve të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në përbërje të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, janë përcaktuar përfaqësuesit, si më poshtë:


- ▣ Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë – Ministër;
- ▣ Ministria e Financave - Zv/Ministër;
- ▣ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes – Drejtor Drejtorie;
- ▣ Ministria e Shëndetësisë - Drejtor i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- ▣ Ministria e Drejtësisë – Drejtor Drejtorie;
- ▣ Instituti i Statistikave – Drejtor i Përgjithshëm;
- ▣ Me VKM nr. 262, datë 07.05.2014 “Për përzgjedhjen e organizatave të punëdhënësve dhe të sindikatave më të përfaqësuar në Këshillin Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, janë përcaktuar 6 përfaqësues nga këto organizata.



Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore:

- ▣ Drejton dhe organizon veprimtarinë e ISSH-së;
- ▣ Emëron Drejtorët e Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore;
- ▣ Raporton pranë Këshillit Administrativ për veprimtarinë e ISSH-së.

ISSH është e organizuar në tre nivele drejtimi: Drejtoria Qendrore, 12 Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, dy Degë të Sigurimeve Shoqërore në Sarandë dhe Tropojë për shkak të largësisë nga qendra, Drejtoria e Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore, si dhe në Agjencitë Lokale të Sigurimeve Shoqërore në nivel qyteti ose qendre banimi, relativisht të mëdha.



KËSHILLI ADMINISTRATIV I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Kryetar

Arben AHMETAJ
Ministër,
Ministria e Financës dhe Ekonomisë

Nënkryetarë

Kolë NIKOLLAJ
Përfaqësues i Konfederatës
së Sindikatave të Shqipërisë

Luan BREGASI
Përfaqësues i Punëdhënësve

Anëtarë

Alban BEQAJ
Drejtor,
Ministria e Ekonomisë

Monika MEÇA
Drejtoreshë,
Ministria e Drejtësisë

Eduard AHMETI,
Drejtor i Përgjithshëm,
FKSSH

Delina IBRAHIMAJ
Drejtoreshë e Përgjithshme,
INSTAT

Naim HASA
Përfaqësues i Punëdhënësve

Avenir KIKA
Përfaqësues i Punëdhënësve


Gëzim KALAJA
Përfaqësues i BSPSH

Bilbil KASMI
Përfaqësues i Sindikatës
së Shqipërisë



Astrit HADO	- Drejtor i Përgjithshëm
Ali EMINI	- Zv/Drejtor i Përgjithshëm
Hasan HOXHA	- Zv/Drejtor i Përgjithshëm
Balciana RAKIPI	- Zv/Drejtoreshë e Përgjithshme
Fatiela MEHMETI	- Drejtoreshë, Drejtorja e Përfitimeve
Brunilda MENE	- Drejtoreshë, Drejtorja e Kontributeve
Miranda GOXHI	- Drejtoreshë, Drejtorja Juridike
Elma FECI	- Drejtoreshë, Drejtorja e Financës
Rezalda SHEHI	- Drejtoreshë, Drejtorja e Integritetit, Reformave, Marrëveshjeve dhe Kërkimit Social
Agim BAÇI	- Drejtor, Drejtorja e Marrëdhënieve me Publikun
Lindita ABDI	- Drejtoreshë, Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit
Sokol LULA	- Drejtor, Drejtorja e Auditit të Brendshëm & Menaxhimit të Riskut
Elvin NURIU	- Drejtor, Drejtorja e Administrimit të Përgjithshëm

STRUKTURA ORGANIZATIVE E ISSH-së



Ligje

- ❑ Ligj nr. 8/2017 “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”;
- ❑ Ligj nr. 25/2017 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 25.01.2017, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”;
- ❑ Ligj nr. 72/2017 “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të personave në pension, sipas ligjit nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit”.

Vendime të Këshillit të Ministrave

- ❑ Vendim nr. 130, datë 22.02.2017 “Për indeksimin e pensioneve”;
- ❑ Vendim nr. 161, datë 01.03.2017 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 409, datë 01.06.2016, të Këshillit të Ministrave “Për ngushtimin e diferencave në masën e pensioneve”;
- ❑ Vendim nr. 411, datë 10.05.2017 “Për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe njohjen si periudhë sigurimi të periudhës kur bashkëshorti/ja ka shoqëruar personelin e shërbimit të jashtëm në misionin diplomatik ose postin konsullor jashtë shtetit”;
- ❑ Vendim nr. 745, datë 13.12.2017 “Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit, 2017”.


ECURIA E REFORMËS NË PENSIONE

Sistemi i sigurimeve shoqërore në Shqipëri, i modeluar në vitin 1993, i ndërtuar pas rënies së sistemit të ekonomisë së përqëndruar, në këto 21 vitet e fundit ka reflektuar ecurinë dhe problematikat e zhvillimit social-ekonomik të vendit. Ai ka kaluar përmes një procesi rregullimi dhe adoptimi të vazhdueshëm, por edhe pas ndërhyrjeve dhe rregullimeve ligjore që iu bënë, përsëri, ai evidentoi mjaft probleme, të cilat mbarteshin dhe në perioda afatmesme dhe afatgjata.

Reforma e re e pensioneve po zbatohet duke filluar nga 1 janari i vitit 2015, duke pasur parasysh që viti 2014 është viti i fundit i zbatimit të formulës ekzistuese të përlllogaritjes së përfitimeve.

Kontribuesit përbëjnë bazën e sistemit, sepse sistemi fillon me kontribuesit dhe kontributet. Masa e kontributeve përcakton sistemin e përfitimeve dhe financohet prej tyre, numri i kontribuesve evidenton treguesin e mbulimit me elemente të sigurimeve shoqërore, si të forcave aktuale të punës, ashtu edhe të popullsisë së moshuar në të ardhmen, duke qenë një element kryesor i shmangies apo reduktimit të varfërisë të moshës së tretë.

Në vitin 2017 u evidentuan 97,821 kontribues më shumë se në vitin 2014, me një tendencë të dukshme drejt rritjes, pasi numri i kontribuesve në fund të vitit 2017 arriti në 763,997 persona.




E gjithë rritja e numrit të kontribuesve i referohet sektorit privat dhe kryesisht personave të punësuar në subjektet juridike private dhe ka ardhur si rezultat i rritjes ekonomike në shkallë vendi.

Problematike mbetet pjesëmarrja e popullsisë së fshatit në skemën e sigurimeve shoqërore. Për të nxitur rritjen e numrit të mundshëm të kontribuesve në fshat, në vitin 2014 u realizua amnistia e detyrimeve të prapambetura. Si rezultat i saj, në vitin 2014 u konstatua një rritje e numrit të kontribuesve me mbi 60 mijë persona, por që është një rritje e paqendrueshme,


pasi në vitet 2015-2017, numri i kontribuesve mbetet në nivelet e rreth 58 mijë personave. Problematikat në rritjen e numrit të kontribuesve në fshat reflektohen edhe në volumin e të ardhurave të akumuluar, si dhe në një deficit të lartë të skemës së fshatit.

Shqipëria është një vend me emigracion të lartë, por për arsye të të drejtave të fituara, të cilat lidhen me periudhat e punës përpara viteve 1990, numri i pensionistëve në raport me popullsinë aktive është i lartë dhe vazhdon të rritet.

Projeksionet evidentojnë rritje të numrit të pensioneve të pleqërisë në raport me popullsinë rezidente. Në vitin 2017 ato arritën në 17,3% ndaj 21,6% që është numri total i pensionistëve ndaj popullsisë rezidente.




Në tre vitet e reformës evidentoher një ritëm mesatar i rritjes së numrit të përfituesve me rreth 12 mijë persona. Ritmi vjen gradualisht në ulje, kjo për shkak të rritjes me dy muaj në vit të moshës së pensionit për gratë, efekt i cili duket qartësisht në uljen e numrit të pensioneve të reja nga viti 2015 e në vazhdim.






Rritja graduale e moshës së daljes në pension ecën sipas skemës së miratuar dhe natyrisht është faktor themelor në mbajtjen brenda parashikimeve të fondit të nevojshëm të pensioneve, si dhe për të reduktuar një pjesë të efekteve që sjell rritja e numrit të përfituesve, krahasuar me popullsinë.

Në harkun e tre viteve 2015 - 2017 numri i kontribuesve në skemën e sigurimeve shoqërore është rritur me mbi 97,800 persona, ndërkohë që numri i përfituesve është rritur me 35,700 persona. Kjo ka sjellë si pasojë përmirësimin e cilësisë të raportit kontribues/përfitues, që është një nga raportet më të rëndësishme të qëndrueshmërisë së sistemit.




Ndërsa në vitin 2014 raporti kontribues – pensionistë në pension pleqërie ishte 1.13 : 1, në vitin 2017 ai arriti në 1.22 : 1, duke shprehur një rritje për një kohë të shkurtër, me një tendencë të qartë drejt përmirësimit.


Një tregues mjaft cilësor që evidenton efektet e reformës së pensioneve, lidhjen e drejtpërdrejtë midis masës së pensionit dhe kontributit, si dhe masat e marra për reduktimin e evazionit të kontributeve, është edhe ritmi i rritjes së të ardhurave si nga viti në vit, ashtu edhe të krahasuara me vitin bazë. (Theksojmë se në vitin 2014 jemi në kushtet e zbatimit të një amnistie për gjopa dhe kamatëvonesa mbi kontributet e personave të vetëpunësuar në bujqësi). Amnistia çoi numrin e kontribuesve nga 64 mijë persona në vitin 2013 në 127.7 mijë në vitin 2014 dhe një shtesë edhe në të ardhurat nga kontributet për rreth 5,600 milionë lekë.




Në vitin 2017, kundrejt vitit 2014, të ardhurat nga kontributet u rritën me 19.1 ose 11,836 milionë lekë më shumë. Ky tregues evidenton rritje edhe ndaj PBB. Në vitin 2014 të ardhurat nga kontributet arritën në 4.4% të PBB, ndërsa në vitin 2017 ato rezultojnë të jenë në nivelin e 4.7% të PBB.



Në harkun e tre viteve, përfitimet mesatare individuale vjetore janë rritur me 18,200 lekë për person ose 14,900 milionë lekë, e barabartë me rreth 0.95% të PBB.




Rikonceptimi i formulës së pensionit, si dhe indeksimi i pensioneve individuale kanë sjellë si pasojë ndryshime në masën mujore të pensionit dhe në veçanti në masën e pensionit mesatar e maksimal.



Një tregues mjaft i rëndësishëm është deficit i skemës së pensioneve, veçanërisht si përqindje e PBB.

Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore të detyrueshme në Shqipëri ndan në vetvete skemën e sigurimeve shoqërore në fshat, ndaj asaj të qytetit. Ndarja është pasojë e ekzistencës së dy sistemeve të veçanta që nga viti 1967 e në vazhdim dhe e diferencave lidhur me kontributet e derdhura. Ish-anëtarët e kooperativave bujqësore, kanë derdhur kontribute në masë shumë më të vogël se sa të vetëpunësuarit në qytet. Për rrjedhojë edhe formula e përlllogaritjes së pensionit ka qenë e ndryshme.

Megjithëse reforma e pensioneve e vitit 2014, parashikon një formulë të njëjtë të përlogaritjes së masës së pensionit, si për qytetin dhe për fshatin, për shkak të diferencimit të bazës së vlerësuar, diferencimet midis skemave do të vazhdojnë të jenë edhe në të ardhmen, së paku deri në vitin 2032, periudhë në të cilën do të vazhdojnë të dalin në pension persona që kanë derdhur për jo më pak se 15 vite kontribute në skemën e ish-kooperativave bujqësore.



Vihet re një ulje në deficitin e skemës së pensioneve të qytetit në harkun e tre viteve të fundit. Nëse për efekt të gjykimit të tendencës në vitin 2017 do të zbresim edhe efektet e bashkimit në pension të kompensimeve për rreth 107 mijë pensionistë, atëherë rezulton që përmirësimi i deficitit të kësaj skeme të jetë i dukshëm, duke arritur në rreth 1% të PBB.

Tendencat drejt përmirësimit të qendrueshmërisë financiare të skemës së qytetit janë të dukshme, si nga treguesit e mësipërm, por edhe nga zhvillimet pozitive të numrit të kontribuesve në qytet, zhvillimet e përgjithshme ekonomike pozitive, si dhe reduktimi i nivelit mjaft të lartë të evazionit të kontributeve, lidhur me pagën mesatare kontributive.

Si përfundim mund të themi se në vitin 2014, u ndërмор një reformë e plotë e sistemit të sigurimeve shoqërore, e cila kishte si qëllim të ndalojë përkeqësimin e mëtejshëm dhe thellimin e deficitit financiar të sistemit të pensioneve, të rindërtojë lidhjen e drejtpërdrejtë të kontributeve të derdhura me masën individuale të pensionit, etj. Kjo reformë filloi zbatimin në janar 2015, dhe natyrisht që dha efektet e veta në të gjithë parametrat e reformuar, të përmendur dhe më lart. Por problematikat e trashëguara të sistemit janë të mëdha dhe ato do të vazhdojnë të mbeten në qendër të vëmendjes edhe për më shumë se një dekadë e më tej.

Instituti Sigurimeve Shoqërore

Siguri e të ardhmes tuaj!



KONTRIBUTE

Realizimi i të ardhurave kontributive në përgjegjësi të ISSH dhe numrit të kontribuesve, duke rritur pjesëmarrjen në skemë të fermerëve dhe institucionalizimi i marrëdhënieve të ISSH-së me DPT, kanë qenë përparësitë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në fushën e kontributeve, për vitin 2017.

Për rrjedhojë, gjatë vitit të shkuar, puna jonë u fokusua në drejtim të realizimit të të ardhurave kontributive të programuara dhe në mënyrë të veçantë të të ardhurave kontributive për të vetëpunësuarit në bujqësi.

Në muajin maj të vitit 2017 u miratua ligji i faljes së kamatëvonesave edhe për të vetëpunësuarit në bujqësi, me kushtin e pagesave të kontributeve të prapambetura të sigurimeve shoqërore të periudhave 2011-2016, deri në fund të vitit 2017.

Gjatë vitit 2017, nëpërmjet zbatimit të programeve informatike, u vazhdua puna me krijimin e bazës të të dhënave të kontributpaguesve dhe të periudhave kontributive të sigurimit të tyre, për të vetëpunësuarit në bujqësi dhe personat e siguruar vullnetarisht, për periudhat e kaluara, si dhe për vitin 2017.

Në muajin maj të vitit 2017, ISSH dhe DPT ranë dakort dhe lidhën Marrëveshje Bashkëpunimi për ripërcaktimin e detyrave dhe komunikimeve ndërmjet tyre, lidhur me procedurat dhe rregullat e transmetimit në formë elektronike të listëpagesave dhe të gjithë informacioneve të tjera, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kundrejt kësaj Marrëveshjeje ISSH mori një pjesë të shërbimit që kryenin Drejtoritë Rajonale Tatimore mbi lëshimin e vërtetimeve, për kontributet e paguara për personat e punësuar dhe personat e vetëpunësuar dhe që i përkasin periudhës nga viti 2012 e në vazhdim.

Ecuria e realizimit të të ardhurave të programuara për vitin 2017

Gjatë vitit 2017 u intensifikuan përpjekjet për plotësimin e detyrës së programuar për të ardhurat nga kontributet e personave juridikë e fizikë (duke përfshirë dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të të vetëpunësuarve në bujqësi, si dhe kontributet nga personat e siguruar vullnetarisht), ku nga 71,868 milionë lekë të programuara u realizuan 73,556 milionë lekë ose 102.3%, me një tejkalim prej 1,688 milionë lekë.

- a. Plani i të ardhurave, nën përgjegjësinë e realizimit nga strukturat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, nga 2,702 milionë lekë u realizua 2,822 milionë lekë, ose 104.4% me një tejkalim prej 120 milionë lekë;
- b. Plani i të ardhurave, nën përgjegjësinë e realizimit nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nga 69,166 milionë lekë u realizua 70,734 milionë lekë, ose 102.3%, me një tejkalim prej 1,568 milionë lekë;
- c. Viti 2017 evidenton përmirësime të ndjeshme të punës së DPT, si në drejtim të realizimit të të ardhurave të krahasuara me vitin 2016, të luftës kundër evazionit të kontributeve, ashtu dhe në drejtim të rritjes së ndjeshme të numrit të kontribuesve dhe mbledhjes së borxheve.

Evidenca e të ardhurave kontributive për periudhën janar - dhjetor 2017

në milionë lekë

Nr	Emërtimi	Gjithsej			Nga këto:					
		Plan	Fakt	në %	ISSH			Tatime		
					Plan	Fakt	në %	Plan	Fakt	në %
1	Sektori Publik	30,066	30,427	101.2	-	-	-	30,066	30,427	101.2
	a. Buxhetore	25,766	26,268	101.9	-	-	-	25,766	26,268	101.9
	b. Jobuxhetore	4,300	4,160	96.7	-	-	-	4,300	4,160	96.7
2	Sektori Privat	37,850	38,802	102.5	-	-	-	37,850	38,802	102.5
	a. Firma	31,400	33,710	107.4	-	-	-	31,400	33,710	107.4
	b. Të vetëpunësuar	6,450	5,092	78.9	-	-	-	6,450	5,092	78.9
3	Sigurim Suplementar	1,250	1,320	105.6	-	5,397	-	1,250	1,314	105.1
4	Sigurim vullnetar	470	483	102.7	470	483	102.7	-	-	
5	Të vetëpunësuar në bujqësi	2,112	2,111	99.9	2,112	2,111	99.9	-	-	
	a. Sigurim shoqëror	2,112	2,111	99.9	2,112	2,111	99.9			
6	Të tjera	120	395	329.0	120	205	170.5	-	190	
7	Derdhur llog të sigurimeve shoqërore	-	18		-	18		-	-	
TOTALI i Sigurimit Shoqëror		71,868	73,556	102.3	2,702	2,822	104.4	69,166	70,734	102.3

Të ardhurat e programuara për subjektet në përgjegjësi të ISSH-së dhe realizimi i tyre për vitin 2017

Të ardhurat e vitit 2017, për subjektet në përgjegjësi të ISSH, nga 2,702 milion lekë që ishte programimi u realizuan në masën 2,822.2 milionë lekë ose 104.4%, me një tejkalim prej 120.2 milionë lekë.

**Evidenca e të ardhurave kontributive për periudhën janar - dhjetor 2017,
për subjektet në përgjegjësi të ISSH-së**

në milionë lekë

Nr	Emërtimi	ISSH		
		Plan	Fakt	në %
1	Të ardhurat nga të vetëpunësuarit në bujqësi	2,382	2,177.9	91.4
	a. të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore	2,112	2,110.8	99.9
	b. të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shendetësore	270	67.0	24.8
2	Të ardhurat nga kontributet e sigurimit vullnetar	470	482.9	102.7
3	Të ardhurat të tjera	120	204.6	170.5
4	Të ardhura për sigurim suplementar të derdhura në DRSSH		5.4	
5	Derdhur në llogari të sigurimeve shoqërore	-	18.5	
GJITHSEJ		2,972	2,889.2	97.2
Zbriten të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shendetësore		270	67.0	24.8
TOTALI i Sigurimit Shoqëror		2,702	2,822.2	104.4

Për të vetëpunësuarit në bujqësi


Të ardhurat nga pagesat e kontributeve të të vetëpunësuarve në bujqësi, për sigurimin shoqëror dhe shëndetësor, nga 2,382 milionë lekë programimi u realizuan 2,177.7 milionë lekë ose 91.4%, me një mosrealizim prej 204.3 milionë lekë.

Ndërsa të ardhurat nga pagesat e kontributeve të të vetëpunësuarve në bujqësi, për sigurimin shoqëror, ishin programuar 2,112 milionë lekë dhe u realizuan 2,110.7 milionë lekë, ose 99.9%, me një mosrealizim prej 1.3 milionë lekë.





Numri i kontribuesve të vetëpunësuar në bujqësi

Numri mesatar i kontribuesve të siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, në fund të vitit 2017, arriti në 58,526 kontribues, ndërsa numri fizik 40,466 kontribues.



Gjatë vitit 2017, u futën në skemë dhe u siguruan si të vetëpunësuar në bujqësi 6,349 fermerë të rinj, ose rreth 15.7% të numrit fizik të të vetëpunësuarve në bujqësi, të siguruar për këtë vit.




Numri mesatar i kontribuesve gjithsej dhe të ndarë sipas sektorëve

Në vitin 2017 numri mesatar i kontribuesve rezultoi 752,383, nga 718,286 në vitin 2016, ose rreth 4.7% më i lartë se një vit më parë, me 34,097 kontribues më shumë.

- ▣ Në sektorin urban, numri mesatar i kontribuesve arriti në 635,885, nga 608,487 në vitin 2016, ose 4.5% më i lartë se një vit më parë, me 27,398 kontribues më shumë;
- ▣ Në sektorin rural, numri mesatar i kontribuesve rezultoi 58,526, nga 53,168 në vitin 2016, ose 10.1% më i lartë se një vit më parë, me 5,358 kontribues më shumë.

Pasqyra e numrit mesatar të kontribuesve për vitin 2017, krahasuar me vitin 2016

Nr	Numri i kontribuesve në përgjegjësi të DPT dhe të ISSH	Numri i kontribuesve për vitin 2017	Numri i kontribuesve për vitin 2016	Krahasimi i vitit 2017 me 2016	
				Diferenca	% e rritjes
I	Numri i kontribuesve për subjektet në përgjegjësi të DPT	627,858	601,164	26,694	104.4
	1 Buxhetore	141,436	137,012	4,424	103.2
	2 Jobuxhetore	18,320	18,389	-69	99.6
	3 Firma	357,630	325,303	32,327	109.9
	4 Të vetëpunësuar	110,472	120,460	-9,988	91.7
II	Numri i kontribuesve për subjektet në përgjegjësi të ISSH	66,553	60,491	6,062	110.0
	1 Të vetëpunësuar në bujqësi	58,526	53,168	5,358	110.1
	2 Të siguruar vullnetarisht	8,027	7,323	704	109.6
III	Numri i kontribuesve të tjerë	57,972	56,631	1,341	102.4
	1 Kontribues për të cilët kontribon shteti (të papunë, në pagesë papunësie, etj.)	41,014	40,780	234	100.6
	2 Numri i kontribuesve me përfitime afatshkurtra	16,958	15,851	1,107	107.0
	Gjithsej (I+II+III)	752,383	718,286	34,097	104.7



Numri i kontribuesve në sektorin urban


- Në sektorin publik u evidentuan 159,756 kontribues, nga 155,401 kontribues për vitin 2016, me një rritje prej rreth 2.8% ose 4,355 kontribues më shumë;
- Në sektorin privat u evidentuan 468,102 kontribues, nga 445,763 në vitin 2016, me një rritje prej rreth 5% ose 22,339 kontribues më shumë.

Ndarë sipas grupimeve:

- Në firmat private, gjatë vitit 2017, u evidentuan 357,630 kontribues, nga 325,303 në vitin 2016, me një rritje prej rreth 9.9%, ose 32,327 kontribues më shumë;
- Në personat fizikë, gjatë vitit 2017, u evidentuan 110,472 kontribues, nga 120,460 në vitin 2016, me një ulje 8.3%, ose 9,988 kontribues më pak.

Sigurimi vullnetar

Të ardhurat nga pagesat e kontributeve të personave të siguruar vullnetarisht, për vitin 2017, ishin programuar 470 milionë lekë dhe u realizuan 482.9 milionë lekë, ose 103%, me një tejkalim rreth 13 milionë lekë.




Numri mesatar i kontribuesve gjatë vitit 2017 arriti në 8,027 persona të siguruar vullnetarisht dhe krahasuar me vitin 2016 pati një rritje me 9.6%, ose me 704 kontribues më shumë. Ndërsa numri fizik i kontribuesve, në fund të vitit 2017, rezultoi 4,786 persona të siguruar vullnetarisht, nga 4,676 persona që ishin siguruar vullnetarisht gjatë vitit 2016, ose 110 persona më shumë.

Në numrin fizik të kontribuesve vullnetarë të vitit 2017, kontribuesit brenda vendit zenë rreth 61% ndërsa emigrantët rreth 39% dhe pothuajse në të njëjtën përqindje që zinin ato në vitin 2016.

Përsa i përket gjinisë, rreth 62% ishin femra, nga 61% në vitin 2016, ndërsa kontribues meshkuj rreth 38%, nga 39% në vitin 2016.



Vihet re një rënie e përqindjes së grupmoshës 18-30 vjeç dhe 31-50 vjeç, si dhe një rritje e përqindjes së grupmoshës mbi 50 vjeç krahasuar me vitin 2016.



Deri në fund të vitit 2017 përfundoi hedhja e pagesave të kontributeve të personave të siguar vullnetarisht në bazën e të dhënave të skemës së sigurimit vullnetar, për periudhën deri në fund të vitit 2016. Nga fillimi i kësaj skeme, në këtë bazë janë regjistruar gjithsej 34,821 persona të siguar vullnetarisht.

Ndërkohë ka vijuar puna për hedhjen e bazës të të dhënave në programin informatik të kontributeve “Contribution Management Information System”. Në këtë program janë hedhur të dhënat në historik për kontribuesit vullnetarë të vitit 2017 për rreth 4,786 persona të siguar vullnetarisht.

PËRFITIMET QË OFRON ISSH

Vazhdimi i punës për implementimin e skemës së reformuar të pensioneve, administrimi i skemës të pensionit social dhe llogaritja e pensioneve me formulën e re, thellimi i parimit kontributiv dhe abrogimi hap pas hapi i skemave të kompensimit të të ardhurave në masën e pensioneve, zbatimi i politikave të Qeverisë për rritjen e të ardhurave të pensionistëve nëpërmjet rritjes së masës së pensioneve, etj, ishin prioriteti ynë edhe gjatë vitit 2017.

Nga sistemi i sigurimeve shoqërore u trajtuan me pagesa përfitimi rreth 621,200 përfitime afatgjatë të të gjitha llojeve e kategorive, si dhe përfitimet afatshkurtër për sëmundje, barrëlindje dhe aksidente në punë e sëmundje profesionale për rreth 17 mijë përfitues.

Gjithashtu ISSH vazhdoi të administrojë skemën e pensioneve të posaçme, skemën e pensioneve suplementare të punonjësve, që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të tjerë të shtetit, skemën e sigurimeve suplementare të ushtarakëve, pilotëve, ushtarakëve të nëndetëseve, policisë së shtetit, skemën e trajtimeve financiare te veçanta për minatorët e punonjësit e industrisë ushtarake, skemën e trajtimeve të veçanta për familjet e dëshmorëve, si dhe pagesat për rimbursimin e shpenzimeve të funeraleve.

Gjatë vitit 2017:

- ▣ U realizuan menjëherë procedurat administrative të rritjes së pensioneve, si dhe pagesave për mbi 640 mijë përfitues nga data 01.03.2017, me një efekt financiar prej 2,600 milionë lekë;
- ▣ U realizua në një kohë rekord e gjithë procedura administrative e dhënies së shpërblimeve për afër 649 mijë përfitues, me një efekt financiar rreth 1,960 milionë lekë;
- ▣ U zbatuan standarte të reja në drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj pensionistëve, sidomos në fushën e transparencës së përfitimeve të caktuara. Hapi më i rëndësishëm u hodh në drejtim të transparencës së pagesave nëpërmjet qeverisjes së tyre me sisteme informatike, të cilat ndër të tjera kanë përmirësuar ndjeshëm edhe administrimin financiar të sistemit;
- ▣ Ka përfunduar databaza e përfitimeve dhe sistemi i informatizuar i pagesave të pensioneve. Gjatë vitit 2017 u futën në sistem 100% e përfitimeve në 9 rajone të Republikës dhe jemi duke vazhduar intensivisht punën, së bashku me Postën Shqiptare, për zbatimin e pagesave nëpërmjet portalit informatik për fshatrat në rajonet Berat, Kukës dhe Tiranë;

- Punë e veçantë është bërë për nxjerrjen dhe dërgimin në destinacion të dokumentacionit të statusit të naftëtarit, duke përpunuar dokumentacionin dhe nxjerrë vërtetime e kopje të librezave për mbi 7,000 dosje pensionesh;
- Një punë mjaft e fokusuar është bërë në kuadër të reformës së deregulimit, ku janë ripërcaktuar shërbimet që ofron ISSH, dokumentacioni që kërkohet dhe mënyra e sigurimit të tij, duke pasur si qëllim pakësimin maksimal të dokumenteve që kërkohen të sigurohen nga kërkuesit dhe duke rritur ndjeshëm bashkëpunimin ndërmjet institucioneve. Në zbatim të këtij objekti brenda muajit dhjetor nëpërmjet bashkëpunimit me sektorët dhe organizatat e tjera u arrit të hiqen nga detyrimi për t'u siguruar nga kërkuesi 75 dokumente të kërkuara, sipas llojit të përfitimit.




Nëpërmjet Degëve të përfitimeve të DRSSH ju është shërbyer në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet caktimit të pensione të reja, mbylljeve, rilogaritjeve, komisionimeve, kompensimeve etj mbi 162 mijë personave.

Në periudhën janar – dhjetor 2017 janë regjistruar pranë zyrave të ALSSH-ve 162,259 kërkesa gjithsej, nga këto: 26% e tyre ose 42,356 janë kërkesa për përfitime për herë të parë dhe 74% e ose 119,903 e kërkesave të ardhura janë kërkesa për rishqyrtime, rikomisionime, mbyllje, kompensime, transferime. Në numrin e kërkesave për përfitime për herë të parë 34,093 janë pensione pleqërie ose 80% të pensioneve total, 5,417 ose 13% janë për pensione invaliditeti dhe 2,846 ose 7% për pensione familjare.


Pensionet

Gjatë vitit 2017 janë caktuar 34,459 pensione të reja nga 35,059 pensione të reja të caktuara në vitin 2016. Evidentohet edhe një rënie e lehtë e pensioneve të reja, ndaj një viti më parë dhe kjo kryesisht në pensionet e pleqërisë, të cilat lidhen me rritjen me dy muaj në vit të moshës së daljes në pension të grave. Rënia e numrit të përfituesve të rinj ka sjellë si pasojë edhe një rënie të lehtë të ritmit të rritjes së numrit të pensioneve, krahasuar me diferencën 2017-2016.




Në zbatim të pikës 3, të nenit 85, të Ligjit nr. 7703 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullores nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, një vend të rëndësishëm ka zënë realizimi i treguesve të afateve të caktimit të pensioneve.

Mesatarisht për caktimin e një pensioni janë dashur 25.4 ditë, nga 45 ditë që është koha maksimale ligjore për lidhjen e një pensioni.



Nga 34,459 pensione të reja 93.2% e tyre, ose 32,133 pensione janë lidhur brenda afatit ligjor dhe koha mesatare e caktimit të tyre është 20.9 ditë.



Gjatë vitit 2017 u trajtuan me pension social, për herë të parë, 430 persona, të cilët nuk plotësonin kushtet për pension pleqërie.

Të ardhurat për paaftësi të përkohshme për sëmundje, barrë lindje dhe aksidente në punë

- Paaftësia e përkohshme në punë, për shkak të sëmundjes: periodha e përfitimit zgjat nga 15 ditë deri në 6 muaj, si pasojë e sëmundjes së përgjithshme dhe deri në 1 vit, si pasojë e aksidentit në punë apo sëmundjeve profesionale. Në këto përfitime përfshihen: të ardhurat për paaftësi të përkohshme nga sëmundje të përgjithshme dhe të ardhura për paaftësi të përkohshme nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale.



- *Paaftësia e përkohshme nga sëmundjet e përgjithshme*: për vitin 2017 janë trajtuar me paaftësi të përkohshme në punë nga sëmundje të përgjithshme 1,600 përfitues;
 - *Paaftësia e përkohshme nga aksidenti në punë dhe sëmundjet profesionale*, ku për vitin 2017 janë trajtuar 37 përfitues.
- ▣ **Barrë lindja**: Gjatë vitit të shkuar janë trajtuar me përfitim për barrë lindje 15,322 përfitues.



Dinamika e shpenzimeve për vitet 2016 - 2017

Shpenzime për përfitime afatshkurtra	2016	2017	rritja në %
Sëmundje	337	371	110.0
Barrë lindje	2,578	3,018	117.1
qytet	1,844	2,241	121.5
fshat	576	595	103.3
shpërblim lindje	157	182	115.9
Aksidente dhe Sëmundje Profesionale	13	14	107.3
TOTALI	2,928	3,403	116.2



Krahasuar me një vit më parë shpenzimet për përfitime afatshkurtra janë rritur me rreth 475 milionë lekë dhe shkak për këtë është bërë numri i më i madh i personave të mbuluar dhe rritja e përfitimit mesatar.

Shpenzimet për përfitimet afatshkurtra në total (barrë lindje, sëmundje dhe aksidente në punë) rezultojnë 3,403 milionë lekë kundrejt 3,171 milionë lekë të programuara, 232 milionë lekë më shumë se programimi ose në masën 107.3% të fondeve të programuara.

Nga këto, shpenzimet për barrë lindje janë realizuar në masën 108.5 % (qyteti 110.3 % dhe fshati 102.2%), shpenzimet për sëmundje 98,9% dhe aksidentet në punë 100.4%.


Megjithëse në pamje të parë konstatohet një tejkalim i ndjeshëm i programit të shpenzimeve, duhet të sqarohet dy faktorë të rritjes së masës së fondeve të shpenzuara:

- ▣ Faktori i parë i ndjeshëm është ai që lidhet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi me rreth 9% ose 6% më shumë se rritja e indeksit mesatar të çmimeve, e cila është bazë për programimin e fondeve. Për vitin 2017, kjo rritje ka pasur një efekt mesatar vjetor prej rreth 4% ose rreth 120 milionë lekë;
- ▣ Faktori i dytë që ka ndikuar është rritja e numrit të lindjeve të siguruara, të cilat kanë përfituar të drejtën për t'u trajtuar. Ky faktor në rradhë të parë lidhet me rritjen e numrit të kontribuesve, por edhe për shkak të pamundësisë për të programuar drejt numrin e përfituesve pasi treguesit statistikorë, veç nënave që lindin dhe janë rezidentë në Shqipëri, evidentojnë edhe lindjen e shqiptarëve jashtë shtetit.



Dinamika e invaliditetit

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në zbatim të politikave sociale lidhur me përfitimet që rrjedhin nga sistemi i sigurimeve shoqërore, ka ndjekur me kujdes dhe në vazhdimësi dinamikën dhe ecurinë e invaliditetit. Vëmendja është përqëndruar në vlerësimin e treguesve kryesorë të invaliditetit në aspektin ligjor, financiar e shoqëror. Për vitin 2017 numri i invalidëve në moshë pune arriti në 62,428 persona.



Përfitimet suplementare

Në skemat e sigurimit suplementar dhe të trajtimeve të veçanta, gjatë vitit 2017 janë trajtuar gjithsej me përfitime rreth 33,884 persona, të cilët, të ndarë sipas skemave janë të grupuar si më poshtë:

Lloji i përfitimit	31.12.2016	Shtesat	Pakësimet	31.12.2017
Sigurime suplementare të ushtarakëve	25,455	2,622	1,798	26,279
a parakohe për vjetërsi shërbimi	10,039	685	1,036	9,688
b sigurim suplementar i ushtarakëve	15,416	1,937	762	16,591
Përfitime nga statusi "dëshmor i atdheut"	354	6	9	351
Përfitime për pilotët fluturues në pension	244	2	10	236
Përfitime për punonjësit e ndërmarrjeve ushtarake	512	19	58	473
Sigurime suplementare shtetërore	2,287	394	92	2,589
a pagesa kalimtare	54	118	46	126
b sigurim suplementar i punonjësve të shtetit	2,233	276	46	2,463
Trajtimi i veçantë dhe pensioni profesional i minatorëve	3,011	457	389	3,079
a trajtimi i veçantë i minatorëve	224	14	180	58
b pensione profesionale të minatorëve	2,787	443	209	3,021
Përfitime për detarët e nëndetëseve në pension	64	1	3	62
Përfitime nga statusi "profesor"	765	74	24	815
TOTALI	32,692	3,575	2,383	33,884

▣ *Përfitimet nga skema e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve*

Në skemën e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve janë trajtuar me përfitime 26,279 persona. Kjo skemë funksionon sipas Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në RSH”, i ndryshuar, dhe trajton me përfitime suplementare ushtarakët e shërbimit aktiv të strukturave të përcaktuara në të. Skema financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga kontributet e të punësuarve në strukturat ushtarake përkatëse.



▣ *Përfitimet suplementare shtetërore*

Gjatë vitit 2017, u miratua Vendimi i Këshillit Administrativ nr.14, datë 20.10.2017, në të cilin janë përcaktuar rregullat e llogaritjes së pagës referuese mesatare për efekt të llogaritjes së pensionit suplementar.

▣ *Skema e minatorëve, sipas Ligjit nr. 150/2014*

Gjatë vitit 2017 janë trajtuar me pension pleqërie 3,079 persona dhe vijon aplikimi i përfituesve të rinj me kushtet ligjore:

- Moshë, 55 vjeç;
- Vjetërsia e përgjithshme 30 vite, nga të cilat 12.5 vite në nëntokë.

Gjatë vitit 2017, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka vijuar intensifikimin e punës për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, duke realizuar nënshkrimin e disa marrëveshjeve të rëndësishme bilaterale në fushën e mbrojtjes shoqërore, për rritjen e hapësirave ligjore dhe administrative për mbrojtjen dhe mbulimin e emigrantëve nga skemat e sigurimeve shoqërore.


Marrëveshje në zbatim:

- ▣ Nga viti 2005 vijon zbatimi i Marrëveshjes në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë. Gjatë vitit 2017, janë ndjekur 15 praktika dhe në total që prej momentit të hyrjes së saj në fuqi, janë realizuar 615 praktika;
- ▣ Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës filloi procesin e implementimit të saj nga 1 janari 2016. Gjatë vitit 2017, janë ndjekur 38 praktika në zbatim të marrëveshjes dhe në total nga momenti i hyrjes së saj në fuqi, janë ndjekur 116 praktika;
- ▣ Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë, ka iniciuar implementimin e saj prej datës 1qershor 2016. Për vitin 2017 janë ndjekur 15 praktika dhe numri në total ka shkuar në 21 praktika;
- ▣ Marrëveshja në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë ka filluar procesin e implementimit nga 1 korrik 2016. Duke marrë në konsideratë numrin e vogël të shtetasve shqiptarë që punojnë dhe jetojnë në Hungari, sigurisht edhe numri i praktikave të ndjekura në zbatim të kësaj marrëveshjeje ka qenë i ulët. Gjatë vitit 2017 janë ndjekur 2 praktika dhe 6 në total nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje;
- ▣ Marrëveshja në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut, u ratifikua nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin nr. 42/2015, datë 16.04.2015 dhe hyri në fuqi më 1 korrik 2016. Në datën 30.03.2017, u nënshkrua Marrëveshja Administrative në zbatim të marrëveshjes kuadër. Gjatë vitit 2017 janë ndjekur 10 praktika dhe në total që prej momentit të hyrjes së saj në fuqi janë ndjekur 13 praktika;
- ▣ Marrëveshja në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke, është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin nr. 34/2016, datë 24.03.2016 dhe zbatueshmëria e saj ka filluar prej datës 01.02.2017. Për vitin 2017 janë ndjekur 11 praktika në zbatim të kësaj marrëveshjeje;

- Marrëveshja në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, është ratifikuar me Ligjin nr. 23/2016, datë 10.03.2016 dhe ka filluar implementimin e saj prej datës 1 dhjetor 2017. Kjo marrëveshje është e një rëndësie të veçantë dhe me ndikim të madh, për shkak të numrit të madh të shtetasve shqiptarë që kanë emigruar në Gjermani, duke arritur të mbrohen të drejtat e tyre të fituara në përputhje me legjislacionin e sigurimeve shoqërore.

Marrëveshje në proces:

- Marrëveshja dypalëshe në fushën e mbrojtjes shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 637, datë 07.09.2016, është nënshkruar në Tiranë në datë 25.01.2017 dhe aktualisht është në pritje të ratifikimit nga Parlamenti Shqiptar dhe më pas caktimit të datës së hyrjes në fuqi;
- Në datat 22 – 23 shkurt 2017, në ambjentet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, u zhvillua takimi dypalësh, ndërmjet përfaqësuesve të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të Shqipërisë, Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës. Gjatë këtij takimi u dakordësua projekt-marrëveshja përfundimtare për njohjen e periudhave kontributive në të dy shtetet dhe në datën 27.11.2017, në Tiranë, kjo marrëveshje u nënshkrua, duke i hapur rrugë procesit të ratifikimit;
- Marrëveshja në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Rumanisë është ratifikuar me Ligjin nr. 42/2016, datë 14.04.2016 nga Parlamenti Shqiptar. Në vijim, pritet të përcaktohen datat nga autoriteti kompetent, gjatë të cilave do zhvillohet takimi i radhës, me qëllim dakordësimin e formularëve zbatues të kësaj Marrëveshje. Kjo marrëveshje nuk ka hyrë ende në fuqi;
- Në datat 02 – 05 maj 2017, u çelën negociatat për hartimin e një marrëveshje në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane, të cilat u mbajtën në ambjentet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në datat 13 – 16 nëntor 2017, në Bernë, u zhvillua raundi i dytë i bisedimeve me delegacionin zviceran, gjatë të cilit u dakordësua teksti përfundimtar i marrëveshjes kuadër me këtë shtet, si dhe një pjesë e marrëveshjes administrative, e cila do shërbejë si një rregullore për zbatimin e marrëveshjes kuadër.





ADMINISTRIMI I BURIMEVE TË INFORMACIONIT

- ▣ **Vazhdimi i mëtejshëm i programit të hedhjes së kartelave të pensioneve dhe të llogaritjes online të përfitimeve**

Gjatë vitit 2017 ka vazhduar puna për hedhjen e kartelave në programin e hedhjes të dosjeve të pensioneve (kartelave elektronike). Ky program bën më efikas veç të tjerave edhe kontrollin për mosabuzim me pensionet.

- ▣ **Sistemi i pranimit online të kërkesave në agjenci**

Procesi fillon në agjenci me pranimin e kërkesave nga aplikuesit. Me ngritjen e ADISA - Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara, pritja e kërkesave për përfitime në disa rrethe bëhet në këto pika. Parimi i punës është i njëjtë. Kërkesat në formë elektronike dërgohen në DRSSH-të përkatëse dhe në këtë moment bëhet shpërndarja e punës për llogaritjen e pensionit online. Në përfundim të aplikimit të kërkesës në agjenci, kërkuesit pajisen me një numër identifikimi, me anë të të cilit mund të kontrollojnë llogaritjen e pensionit të tyre online në faqen e web-it të ISSH-së - <http://epensione.iss.gov.al/>.

